



Drejtoria e Administratës

Zyra për Barazinë Gjinore

02Nr 06-18005 /24

Klinë, dt: 03.06. /24

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik për Draft-Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026, mbajtur, më 14.05.2024, me fillim nga ora 13:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Nënkyetarja e Komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi - Selmanaj, i cila përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e pastaj hapi diskutimin me këtë rend dite:

1.Shqyrtimi i Draft-Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026

Marqe Tanushi - Selmanaj: Atëherë përshëndetje për të gjithë! Faktikisht ky takimi është i thirrur edhe i njoftuar edhe përmes rrjeteve sociale. E nderuara zyrtare për barazi gjinore, zonja Vitore Shala. Të nderuara zonja nga institucionet tona komunale, të nderuar qytetarë, i nderuari zyrtarë nga zyra burimeve njerëzore, që në të njëjtën kohë je edhe anëtar i grupit dhe anëtarë tjerë të grupit. Faleminderit shumë për prezencën tuaj!

Atëherë, sot si pikë të rendit të ditës e kemi konsultim me publikun në lidhje temën e shqyrtimi i draft-planit lokal të veprimit për barazi gjinore, i cili është për vitin 2024-2026.

Ky plan është përgatitë nga komuna e Klinë, e kemi këtu edhe grupin, i cili, nëse ka nevojë edhe prezantojmë, ndërsa është mbështetë nga UN WOMAN në Kosovë, në kuadër të projektit GEF me fonde të Bashkimit Evropian. Koordinator i këtij projekti është Artan Binaku, ndërsa konsulentë ndërkombëtare është Monika Kosaçi. Pra, këta kanë qenë dy anëtarët kryesorë, të cilët na kanë ndihmuar në përpilimin e këtij plani dhe sipas të zyrtares për barazi gjinore Vitores, thotë që është plani më i mirë i mundshëm i bërë deri më tash.

Tani tek pjesa tjetër gjatë elaborimit, të gjithë të interesuarit kanë mundur ta shohin sepse ka qenë i publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës së Klinës si dhe platformën e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës. Por, për më shumë informacione ja dhë fjalën zyrtares për Barazinë Gjinore, znj. Vitore Shala.

Vitore Shala: Përshëndetje, nënkryetare! Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit që janë këtu. Si zyrtare për barazi gjinore e falënderoj më së pari grupin punues, i cili ka punuar në këtë plan me përkushtim shumë të madh dhe të mirë, Dua të falënderoj për mbështetje UN WOMAN në Kosovë, në kuadër të projektit GEF me fonde të Bashkimit Evropian të cilët kanë financuar së paku tri-katër takime apo punëtori, me përfaqësues, të cilët i falënderoj edhe Monika Kocaçi dhe Artan Binaku, njëherë i falënderoj edhe zyrtaren, zonjushën Vlora Tafili e cila u kon shumë aktive në përgatitjen e këtij dokumentacioni sa i përket procedurave të konsultimit publik me njoftime, agjendën e takimeve, publikimin, informimin e mediave e të të gjithë grupeve tjera të interesit.

Komuna e Klinës po bëhet një plan trevjeçar, i cili ka për qëllim të krijojme një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

Edhe pse plani ka të bëjë me barazinë gjinore, duke mos anashkalua as meshkujt, as djemtë. as vajzat, po si gjithmonë, sa herë që flitet për barazi gjinore në një aktivitet, në një punëtori, pjesa më e madhe pjesëmarrëseve kryesisht janë gra.

Megjithatë, ky plani i cili është i punuar me përkushtim, andaj si pjesë të veçantë ka edhe kostimin po shpresoj që keni arrit me i pa dhe analizur të gjitha shifrat. Viteve në vazhdim 2024 e deri në 2026 na presin shumë aktivitete në dobi të barazisë gjinore e që do të arrijmë ti implementojmë bashkërisht. Sidomos tek pjesa e subvencioneve e cila është realizuar në formë të shkëlqyer nga Zyrtarja Kryesore Financiare, e që i kemi prapa ato ndarje nëpër kategori të ndryshme. Ne në kuadër të këtij plani kemi përfshi edhe kategoritë ose disa punë që zakonisht i kemi bërë edhe më herët në kuadër të Zyrës për barazi gjinore, gratë të cilat kanë dhunë në familje, gratë e kategorive të cënueshme, gra të cilat kanë gjendje të dobët sociale e tjerë e tjerë, pra jemi mundu me ju orfu një zgjidhje që, ndoshta nuk është ajo më e mira, më e duhura që ne mundemi me ju ndihmua me aq sa na pasu mundësi si Komunë duke pasur parasysh faktin që pjesë e gjithë këtij plani janë të gjitha institucionet komunale.

Unë nuk kam se çfarë të shtojë me shumë, pres ndonjë koment apo pyetje e sugjerim nga ana juaj sepse po mbahet procesverbali dhe pyetjet dhe kërkesat tuaja po regjistrohen dhe sigurisht që do të merren parasysh e do të trajton në raportin final të këtij konsultimi.

Marqe Tanushi - Selmanaj: Ky plan ka me na i mundësu disa pika të cilat na kena me pas ku me mu fokusu vitet në vazhdim. Kur ke gjithçka në plan, jam shumë e sigurt që t'u ndjek hapat, nuk ka me lënë asgjë mbrapa pa trajtuar. I tillë është ky draft-plan, i cili na mundëson që vetëm t'u bazuar në këto korniza me bë punë shumë të mira në kauzat e barazisë.

Ta përsëris edhe një herë, jo vetëm në aspektin gjinor barabarësi të grave, por të grave, të burrave, të vajzave dhe djemve, sidomos në vende pune, në vendimmarrje, në fuqizimin ekonomik.

Andaj çfarëdo që të keni ju tjetër të shtoni që mendoni se do ti kontribuonte këtij dokumenti, urdhëroni fjala është e juaja.

Po urdhëroni, z Enver Mala.

Enver Mala: Unë vetë uroj që ky plan gjen zbatim përpikmeri. Ka një bazë të fuqishme ligjore të reflektuara në: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit, Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave, Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritetit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj. Unë kam qenë edhe pjesë e grupit punues, e di përmbajtjen e tij, andaj vetëm uroj të implementohet në mënyrën e duhur e të keni suksese në realizimin e aktiviteteve.

Marqe Tanushi - Selmanaj: Faleminderit shumë Enver. A ka dikush tjetër? Siç po shihet jo, atëherë unë s'po ju marr kohë më shumë, ju falënderoj shumë për zemërsisht çdonjërin këtu, veç e veç për pjesëmarrjen tuaj. Faleminderit shumë!

Takimi u mbyll në ora 13:42.

**Procesmbajtësja,
Vlora Tafili**



**Nënkryetarja,
Marqe Tanushi Selmanaj**